Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/501
Datë: 01.08.2024

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 16 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, nenit 5 paragrafi 4, 5 dhe 6 si dhe nenit 6 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 01/196 e punës e Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 25.07.2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. **Akreditohet dhe Validohet** Kolegji "UNIVERSUM" me adresë: Rr. "Haki Stermilli" në Ferizaj, 70 000, Republika e Kosovës, për periudhën 3 (tre) vjeçare, përkatësisht nga data 25.07.2024 deri 24.07.2027, me kualifikimet e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK):

   1.1 **Bashkëpuntor Profesional i Infermierisë**, Niveli III dhe IV i KKK, lloji: Kualifikimet kombëtare të Kombinuara (C) me 180 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin mësimor në 2 (dy) klasë me nga 24 (njëzetekatër) nxënës për 1(një) cikel. Numri i nxënësve në ushtrimet praktike në shkollë për këtë kualifikim të jetë i ndarë në 2 (dy) grupe me nga 12 (dymbëdhjetë) nxënës për secilen klasë, ndërsa në praktikë në institucionet e kujdesit shëndetësor nga 3 (tre) grupe me nga 8 (tetë) nxënës për secilën klasë. Numri total i nxënësve për një cikël të jetë 48 (katërdhjetetetë) nxënës.

   1.2 **Teknik Dentar**, Niveli III dhe IV i KKK, lloji: Kualifikimet kombëtare të kombinuara (C) me 180 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin mësimor me 25 (njëzetepesë) nxënës brenda një klasë në orët e mësimit teorik, i ndarë në dy grupe me nga 12/13 për punën praktikën në laboratorë të shkollës, ndërsa për pjesën praktikën në institucione tjera të kujdesit shëndetësor jo më shumë se 6-8 nxënës për grup.

   1.3 **Asistent i Fizioterapisë**, Niveli III dhe IV i KKK, lloji: Kualifikimet kombëtare të kombinuara (C), me 180 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin mësimor me 1(një) klasë me 24 (njëzetekatër) nxënës për 1 (një) cikël. Numri i nxënësve për ushtrimet praktike në shkollë të jetë i ndarë në 3 (tri) grupe me nga 8 (tetë) nxënës për secilën klasë,

ndërsa në praktikë në institucionet e kujdesit shëndetësor nga 3 (tre) grupe me nga 8 (tetë) nxënës për secilën klasë. Numri total i nxënësve për një cikel të jetë 24 (njezetekatër) nxënës.

2. **Akreditohet dhe Validohet** me Kusht Kolegji "UNIVERSUM" me adresë: Rr. "Haki Stermilli" në Ferizaj, 70 000, Republika e Kosovës, për periudhën 3 (tre) vjeçare, përkatësisht nga data 25.07.2024 deri 24.07.2027, me kualifikimet e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK):

   2.1. **Teknologji Digjitale**, Niveli III dhe IV i KKK, lloji: Kualifikimet kombëtare të kombinuara (C), me 180 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin mësimor me 2 (dy) paralele me nga 24 (njezetekatër) nxënës në klasën e 10, 2 (dy) paralele me nga 24 (njezetekatër) nxënës në klasën e 11 dhe me 2 (dy) paralele me nga 24 (njezetekatër) nxënës në klasën e 12.

   2.2. **Mekatronikë – Operator i Robotëve Industrial**, Niveli III dhe IV i KKK, lloji: Kualifikimet kombëtare të kombinuara (C), me 180 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin mësimor me 20 (njëzetë) nxënës për vit. Numri maksimal i nxënësve për realizimin e pjesës praktike në laboratorë mund të jetë 5-7 nxënës.

3. Institucioni Kolegji "Univesum" është akredituar dhe validuar për ofrimin, vlerësimin dhe certifikimin e kualifikimit Teknologji Digjitale niveli III dhe IV i KKK me kushtin si në vijim:

   3.1. Kolegji "Universum" të kërkojë zgjatjen e afatit të regjistrimit të nxënësve nga Pearson.

   3.2. Institucioni obligohet të plotësoj kushtin e përcaktuar në paragrafin 3 pika 3.1 të këtij vendimi deri me datë 01.01.2025.

4. Institucioni është akredituar dhe validuar për ofrimin, vlerësimin dhe certifikimin e kualifikimit Mekatronikë – Operator i Robotëve Industrial, niveli III dhe IV i KKK me kushtet si në vijim:

   4.1. Të sigurohen dhe dëshmohen përmes fotografive dhe me video nga sallat mësimore apo laboratorëve paisjet laboratorike që mund tu shërbejn nxënësve për realizimin e pjesës praktike të lëndëve specifike-profesionale të programit Megatronikë-Operator i robotëve industrial. Kjo listë e paisjeve kompjuterike duhet të jetë e veçantë për lëndët profesionale dhe nuk i përfshin paisjet aktuale të përgjithshme apo ato të planifikuara sipas Grantit të fituar nga ana e institucionit.

   4.2. Të angazhohet stafi profesional me kualifikim adekuat, me kontratë për kohë të plotë, për lëndët profesionale të programit Mekatronike-Operator i Robotëve Industrial.

4.3. Të sigurohen marrëveshje me institucionin kompetent për fushën e makatronikës, për realizimin e pjesës praktike të nxënësve.

4.4. Të definohet qartë, me marrëveshje, roli i këtyre institucioneve në përmbushjen e kompetencave të nxënësve nga lemi i ngusht i makatronikës dhe lëndëve tjera që janë pjesë e plan programit (marrëveshjet kompani-kandidat, raporte pune, detyra pune, projekte me kandidatet në vendin e punës, monitorim dhe vlerësim të kandidatëve).

4.5. Të sigurohet dhe dëshmohet, analiza e tregut të punës në Kosovë, që ndërlidhet me nevojën e identifikuar të industrisë apo sektorit dhe mban të dhëna konkrete, raporte statistikore konkrete apo rezultate konkrete nga intervista, të cilat mbeshtesin kërkesën për një kualifikim të tillë në nivelin 3 dhe 4 sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve.

5. Institucioni obligohet që kushtin si në paragrafin 4 pika 4.1 të këtij vendimi ti plotësoj deri me datë 30.06.2024, ndërsa kushtet nga paragrafi 4 pika 4.2, 4.3, 4.4. dhe 4.5 ti plotësoj para fillimit të procesit mësimor deri me datë 01.09.2024.

6. Obligohet institucioni të plotësoj kushtet bazuar në vendimin e Këshillit Drejtues Nr. 01/402, i datës 13.06.2024.

7. Obligohet Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve të bëjë monitorimin bazuar në legjislacionin në fuqi dhe bazuar në afatet e aprovuara në raportet e akreditimit dhe validimit dhe të raportoj tek Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve.

8. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Kolegji "UNIVERSUM" me datë 15.12.2023 ka parashtruar në AKK kërkesë për akreditim dhe validim të institucionit për kualifikimet: Bashkëpuntor Profesional i Infermierisë, niveli III dhe IV i KKK, Teknik Dentar, niveli III dhe IV i KKK, Asistent i Fizioterapisë, niveli III dhe IV i KKK, Teknologji Digjitale, niveli III dhe IV i KKK, Mekatronikë – Operator i Robotëve Industrial, niveli III dhe IV i KKK e cila është protokoluar dhe ka marr numër 01/798. Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve bazuar në dispozitat ligjore në fuqi nga fushëveprimtaria e AKK-së ka caktuar ekipet e eksperteve të jashtëm me qëllim të vlerësimit të institucionit lidhur me përmbushjen e kritereve për akreditim dhe validim për kualifikimet si më lartë.

Ekipet e ekspertëve pas shqyrtimit të dosjeve të aplikimit, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi kanë realizuar vizitën në Kolegjin "UNIVERSUM" dhe kanë përpiluar raportet vlerësuese për akreditim